



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM

Nr. 149 Datë 22.12.2021

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2023-2025 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2023 BASHKIA KORÇË**

Këshilli Bashkiak Korçë, në mbledhjen e datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga ekzekutivi i Bashkisë, "Për miratimin e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të Buxhetit Vjetor 2023 Bashkia Korçë", mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimit nr.23, datë 30.7.2018 "Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve të anëtarëve

VENDOSI:

1. Të miratojë kalendarin për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të Buxhetit Vjetor 2023 të Bashkisë Korçë si më poshtë:

Struktura Përgjegjëse	Veprimi përkatës	Periudha
Kryetari i Bashkisë dhe GMS	Hartimi dhe paraqitja për miratim në Këshillin Bashkiak i kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të Buxhetit Vjetor 2023.	Jo më vonë se data 31 dhjetor 2021 dhe hyn në fuqi në datën 1 janar 2022.
Kryetari i Bashkisë	Shpërndarja e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor tek të gjitha njësitë shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore.	Pas miratimit në Këshillin Bashkiak.
Kryetari i Bashkisë, të gjitha Drejtoritë e Bashkisë, Institucionet e vartësisë dhe NJA.	Përgatitja e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore.	Jo më vonë se data 31 janar 2022.
Këshilli Bashkiak	Miratimi i raportit të vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve.	Jo më vonë se data 1 mars 2022.

Kryetari i Bashkisë, GMS dhe EMP	Përgatitja dhe paraqitja për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore i tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.	Jo më vonë se data 15 mars 2022.
Këshilli Bashkiak	Miratimi i tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	Jo më vonë se data 15 mars 2022.
Kryetari i Bashkisë	Miratimi i udhëzimit të përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shpërndarja tek të gjitha njësitë shpenzuese.	Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.
EMP	Përgatitja e kërkesave buxhetore.	21 mars -25 prill 2022.
Kryetari i Bashkisë, GMS	Zhvillimi i takimeve konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit për programin buxhetor afatmesëm 2023-2025.	26 - 27 prill 2022.
EMP	Paraqitja e kërkesave buxhetore të përgatitura.	28 - 30 prill 2022.
Drejtorja e Financës, Sektori i Buxhetit	Kryerja e analizave të kërkesave buxhetore.	1 - 15 maj 2022.
Kryetari i Bashkisë, GMS	Organizim i seancave dëgjimore me banorët.	16 - 26 maj 2022.
Kryetari i Bashkisë	Prezantimi i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 me shoqërinë civile.	27 - 29 maj 2022.
Drejtorja e Financës, Sektori i Buxhetit	Hartimi i draftit të fazës së parë të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025.	30 - 31 maj 2022.
Kryetari i Bashkisë	Dërgimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë i projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025.	Brenda datës 1 qershor 2022.
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë analizon dhe përgatit një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025.	Brenda datës 20 qershor 2022.
Kryetari i Bashkisë	Paraqitja në Këshillin e Bashkisë të projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm dhe mendimin zyrtar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	Brenda datës 30 qershor 2022.
Këshilli Bashkiak	Shqyrtim dhe miratim i projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm, duke shprehur dhe opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.	Brenda datës 30 qershor 2022.
Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Marrëdhënieve	Publikimi i dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar.	Brenda datës 5 korrik 2022.

6	më publikun dhe informimin qytetar		
	Kryetari i Bashkisë, GMS dhe EMP	Përgatitja e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.	Brenda datës 1-15 korrik 2022.
	Këshilli Bashkiak	Miratim i tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	Brenda datës 20 korrik 2022.
	Kryetari i Bashkisë	Nxjerrja e udhëzimit plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shpërndarja tek të gjitha njësitë shpenzuese.	Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të tavanëve të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.
	EMP	Përgatitja e kërkesave buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.	26 korrik-15 gusht 2022.
	Kryetari i Bashkisë, GMS	Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit. Procesverbalet e takimeve, së bashku me qëndrimet përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, bëhen pjesë e dokumentit të projektit të programit buxhetor afatmesëm.	26 korrik-15 gusht 2022.
	EMP	Paraqitja në Bashki e kërkesave buxhetore të rishikuara.	15- 20 gusht 2022.
	Drejtoria e Financës, Sektori i Buxhetit	Kryerja e analizave të kërkesave të rishikuara buxhetore.	21 - 31 gusht 2022.
	Kryetari i Bashkisë	Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij.	Brenda datës 1 shtator 2022.
	Këshilli Bashkiak	Paraqitja për shqyrtim dhe miratim i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar.	Brenda datës 15 shtator 2022.
	Kryetari i Bashkisë	Dërgim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë.	Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak brenda datës 15 shtator 2022.
	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Zhvillimi i seancave të konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore.	Brenda datës 5 tetor 2022.
	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA.	Brenda datës 20 tetor 2022.

Kryetari i Bashkisë, GMS dhe EMP	Përgatitja e projekt programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe paraqitja për shqyrtim e miratim në Këshillin Bashkiak, së bashku me projektbuxhetin vjetor.	Jo më vonë se data 30 nëntor 2022.
Këshilli Bashkiak	Paraqitja për shqyrtim dhe miratim i programit buxhetor afatmesëm përfundimtar.	Jo më vonë se data 25 dhjetor 2022.
Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Marrëdhënieve me publikun dhe informimin qytetar.	Publikimi i dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre.	Jo më vonë se data 31 dhjetor 2022.
Kryetari i Bashkisë	Publikim i buxhetit vjetor përfshirë dokumentacionin shoqërues të tij, në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare Bashkisë.	Jo më vonë së 15 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.
Kryetari i Bashkisë	Dërgim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë i buxhetit vjetor 2023.	Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tij.
Nëpunësi Autorizues	Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak, Nëpunësi Autorizues detajon fondet buxhetore për të gjitha njësitë shpenzuese dhe ua dërgon zyrtarisht njërive shpenzuese.	Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha Drejtoritë e Bashkisë, Institucionet e Varësisë dhe Njësitë Administrative.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

ERJON NEXHIPI

